



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. 1071 / Prot.

Tiranë, më 30/1.2019

**U R D H Ë R**

Nr. 82, datë 30/1 /2019

**P Ë R**

**NJË SHITESË NË URDHRIN NR.250, DATË 29.7.2011 "MBI DISA MASA PËR HYRJEN  
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PRODUKTEVE  
USHQIMORE"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar,

**U R D H Ë R O J:**

1. Në urdhrin nr.250, datë 29.7.2011 "Mbi disa masa për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të produkteve ushqimore", pas pikës 3 shtohen pikat 3/1, 3/2 dhe 3/3 me këtë përmbajtje:

"3/1. Produktet ushqimore me origjinë jo shtazore për konsum njerëzor, të prodhuara në vend dhe të eksportuara, mund të ri-importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet PIK, nëse janë brenda afatit të jetëgjatësisë së tyre të deklaruar në etiketë ose dokumentin shoqërues.

3/2. Operatori i biznesit ushqimor të njoftojë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, të paktën 24 orë më parë, për ngarkesën e riekportuar sipas pikës 3/1 të këtij urdhëri.

3/3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të garantojë që shitja e produkteve ushqimore, sipas pikës 3/1 të këtij urdhri, është bërë brenda afatit të jetëgjatësisë së tyre."

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme Rregullore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

